



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 163, datë 12.07.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
“RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT LIGJOR TË TË
LICENCUARIT OSE NDRYSHIMIN E ORTAKUT/AKSIONERIT QË
KONTROLLON INTERESAT E TË LICENCUARIT”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërma “g”, si dhe nenit 51, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 13, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 26, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.07.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 102/1 prot., datë 30.06.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës, i ngritur me urdhrin nr. 45, datë 15.06.2021, të Kryetarit të ERE-s, për hartimin e “Draft-Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit”,

Konstatoi se:

- Në kushtet e licencave të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe në sektorin e gazit natyro04
- është përcaktuar se nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose nëse aksioneri/ortaku që kontrollon interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.
- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit ka për qëllim të përcaktojë procedurën, dokumentacionin e kërkuar dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për të licencuarit në një nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike ose të gazit natyror, që paraqesin kërkesën për:
 - ndryshimin e statusit ligjor;

- ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;
 - hipotekimin, barrësimin, lënien peng barrë, ose çfarëdolloj disponimi tjetër të të tretët të kuotave apo aksioneve, kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortakut/aksioneri që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar.
- *Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit* trajton çështjet në lidhje me autoritetin, qëllimin, fushën e zbatimit, paraqitjen dhe përmbajtjen e kërkesës, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, shqyrtimin e aplikimit, vendimmarrjen e bordit, njoftimin e vendimit dhe përmbajtjen e regjistrit të autorizimeve të dhëna nga ERE;

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit*
2. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 30 ditëve kalendarike nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe brënda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare për të licencuarit në sektorin e gazit natyror..

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI